



Vëllimi 3, Numri 18

Dhjetor 2022

# BULETINI KUNDËR TERRORIZMIT

PËR BALLKANIN, RRETH BALLKANIT

## NË KËTË NUMËR

Lajme dhe informacione kundër terrorizmit – 1

Joe Baldwin merr postin si Këshilltar Ligjor kundër Terrorizmit i OPDAT për Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut – 2

Kosova akuzon një LHT të riatdhesuar për terrorizëm dhe rekrutim - 2

Miratimi i kriptomonedhës mbetet i lartë, sipas një raporti të ri - 2

Raporti i GWU: Mbështetësit e Shtetit Islamik ruajnë kalifatin virtual përmes përshtatjes dhe novacionit – 3



# OPDAT

Lajme dhe informacione lidhur me terrorizimin për përditësimin dhe komunikimin mes partnerëve tanë në rajon

*Departamenti i Drejtësisë, Zyra e Ndihmës Zhvillimore dhe Trajnimit Prokurorial (OPDAT) në partneritet me Departamentin Amerikan të e Shtetit, Byroja e Antiterrorizmit*

Në këtë numër, ju prezantojmë me Joseph Baldwin, këshilltarin e ri ligjor kundër terrorizmit të OPDAT-it me qendër në Tiranë. Nga Ballkani, Kosova ka paditur së fundmi një LHT të riatdhesuar në Kosovë këtë vit. Ju sjellim një tablo të situatës së miratimit të kriptomonedhave në mbarë botën nga Chainalysis, si dhe disa vëzhgime nga Universiteti George Washington mbi metodat dhe rrjetet në internet që përdorin mbështetësit e terrorizmit për përhapjen e propagandës.

Tom Saunders  
Këshilltar Ligjor kundër  
Terrorizmit për Ballkanin  
OPDAT/DD  
Ambasada e SHBA, Sarajevë  
[SaundersTN@state.gov](mailto:SaundersTN@state.gov)

Joe Baldwin  
Këshilltar Ligjor kundër  
Terrorizmit për Ballkanin  
OPDAT/DD  
Ambasada e SHBA, Tiranë  
[BaldwinJR@state.gov](mailto:BaldwinJR@state.gov)

Jasenska Ferizović  
Këshilltare Ligjore  
OPDAT/DOJ  
Ambasada e SHBA, Sarajevë  
[FerizovicJ@state.gov](mailto:FerizovicJ@state.gov)

Bledar Bashanoviq  
Specialist Ligjor  
OPDAT/DOJ  
Ambasada e SHBA, Tiranë  
[BashanoviqB@state.gov](mailto:BashanoviqB@state.gov)

# Joe Baldwin merr postin si e Këshilltarit Ligjor të OPDAT kundër Terrorizimit për Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut



Kemi kënaqësinë të bëjmë të ditur se më 5 dhjetor, Joe Baldwin filloi si Këshilltari i ri Ligjor rajonal kundër Yerrorizmit (RLA) me seli në Tiranë, Shqipëri, si pjesë e Zyrës së Departamentit të Drejtësisë (DD) të SHBA për Ndhimën Zhvillimore dhe Trajnimin Prokurorial (OPDAT). Ai do të jetë përgjegjës për ngritjen e kapaciteteve kundër terrorizmit, mentorimin e bazuar në raste konkrete dhe ndihmën legislative në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Do të punojë ngushtë me Këshilltarin rajonal të Anti-Terrorizmit të OPDAT-it në Sarajevë, së bashku me Departamentin e Sigurisë Kombëtare të SHBA-së (DSK) dhe Programin Ndërkombëtar të Ndhimës për Hetimin e Krimit të SHBA-së (ICITAP). Para se të merrte postin e Këshilltarit të Anti-Terrorizmit, Joe ka qenë Ndhimës Prokuror në SHBA për Distriktin e Maryland, ku ka ndjekur penalisht një shumëllojshmëri të gjerë krimesh, duke përfshirë edhe eksportimin e paligjshëm të armëve të zjarrit, krimet financiare dhe krimin e organizuar. Joe ka qenë këshilltari kryesor në një numër të madh gjyqesh. Më herët në karrierën e tij, Joe ka qenë avokat për çështje civile. Ka përfaqësuar Shtetet e Bashkuara në një sërë çështjesh civile, duke përfshirë çështjet gjyqësore, mosmarrëveshjet e punësimit dhe çështje që kanë të bëjnë me lirinë e informimit. Ndërkohë, në sferën private, ka përfaqësuar kompani teknologjike në çështjet gjyqësore të patentave dhe tregtisë në lidhje me integrimin e teknologjive të ndryshme në atë që do të shndërrohej në telefon inteligjent (smart phone). Para shkollës juridike, Joe ka shërbyer në Marinën e Shteteve të Bashkuara si oficer lufte në një shkatërrues raketash të drejtuar. I diplomuar nga Akademia Detare e Shteteve të Bashkuara, Universiteti i Maryland-it dhe Shkolla e Drejtësisë e Universitetit të Virxhinias. Ai do të jetojë në Tiranë, Shqipëri, bashkë me bashkëshorten.

## Kosova akuzon një LHT të riadhesuar për terrorizëm dhe rekrutim

Më 25 tetor 2022, Departamenti i Anti-Terrorizmit i Prokurorisë Speciale të Kosovës ngrii padi ndaj Ylber Belës, duke e akuzuar atë për pjesëmarrje në një organizatë terroriste dhe për rekrutim për qëllime terroriste. Bela është riadhesuar në fund të majit të këtij viti gjatë një aksioni të përbashkët riadhesimi të zhvilluar nga Kosova dhe Shqipëria, me ndihmën e SHBA.

Sipas aktakuzës, në vitin 2013 Bela organizoi udhëtimin për vete dhe për një tjetër bashkëlloftëtar për në Siri, ku iu bashkuan radhëve të Jabhat-al Nusra dhe ISIS-it. I njohur edhe si "Abu Hamza al-Kosovi", ai ishte regjistruar në stërvitje për armë për tre javë, para se të angazhohej në aksione ushtarake të ISIS-it. Duke iu referuar ndihmës me provat ofruar nga autoritetet amerikane, prokuroria siguroi prova materiale dhe dëshmi nga bashkëlloftëtarët e të pandehurit që tregonin se ai ishte regjistruar si luftëtar në regjistrin e luftëtarëve të huaj terroristë të ISIS-it. Provat tregonin se Bela ishte angazhuar në aktivitete terroriste të ISIS-it deri në rënien e të ashtuquajturit Kalifat Islamik.

Këshilltari Ligjor kundër Terrorizmit i DD/OPDAT lehtësoi shkëmbimin e provave nga fushëbeteja për këtë çështje përmes kanaleve të ndihmës së ndërsjellë juridike mes autoriteteve të SHBA dhe Kosovës.

*Aktakuza është thjesht një grup akuzash. I pandehuri prezumohet i pafajshëm derisa i provohet fajësia në gjykatë.*

**Burimi:** Prokuroria Speciale e Kosovës

## Adoptimi i kriptomonedhës mbetet i lartë, sipas Raportit të Ri

Investimi në kriptomonedhë mbetet i lartë pavarësisht paqëndrueshmërisë së madhe së fundmi të çmimeve sipas një raportit të ri nga Chainalysis.

Chainalysis është një firmë amerikane që shet softuerë për të ndihmuar në analizën e blockchain dhe raporton mbi tendencat e kriptomonedhave në mbarë globin. Këtë vit, Chainalysis publikoi raportin e tretë vjetor mbi Indeks Global të Adoptimit të Kriptove, i cili rendit 146 vende bazuar në nivelin e tyre të adoptimit "në bazë" të kriptomonedhës. Në vend që t'i renditë vendet sipas volumit të parë të transaksioneve, raporti i përshtatet popullsisë dhe pasurisë së secilit vend për të përcaktuar se ku po e investojnë njerëzit pjesën më të madhe të parave të tyre në kriptovaluta.

Raporti Chainalysis nuk trajton drejtpërdrejt financimin e terrorizmit, por përfundimet e raportit duhet të tërheqin vëmendjen e hetuesve dhe të prokurorëve të anti-terrorizmit. Kripto mbetet një mjet joshës për kriminelët e të gjitha llojeve

për të ruajtur dhe transferuar vlerën, veçanërisht në juridiksionet me rregullore të dobëta ku hetuesit nuk i monitorojnë transaksione të tilla.

Sipas këtij raporti, adoptimi global i kriptomonedhës ka pasur një lloj stabilizimi kohët e fundit. Që nga mesi i vitit 2019, adoptimi po rritej vazhdimisht, duke shënuar një ndër nivelet më të larta të rritjes të të gjitha kohërave në tremujorin e dytë të 2021-shit. Që nga ajo pikë, adoptimi ka lëvizur lart e poshtë me valë të ndryshme, por adoptimi global mbetet shumë më lart se nivelet e tij para 2019-ës. Shumë nga konsumatorët dhe investitorët që filluan ta përdorin kriptomonedhën në 2020-ën dhe 2021-shin vazhdojnë të investojnë edhe pse çmimet janë bërë më pak të qëndrueshme.

Në analizën që ofron ky raport, shtetet e Ballkanit grupohen bashkë me vendet e tjera të Evropës Perëndimore dhe, është e vështirë të nxirren përfundime specifike për rajonin e Ballkanit duke u mbështetur vetëm te ky raport. Për krahasim, raporti vlerëson se pothuajse 20% e të gjithë vlerës së kriptomonedhës së marrë në Evropën Lindore është e lidhur me aktivitete të rrezikshme ose të paligjshme, më shumë se në çdo rajon tjetër.

Shumë nga shtetet e Ballkanit renditen në nivele të ulëta sa i përket futjes në përdorim në përgjithësi të kriptomonedhave, por relativisht të larta në përdorimin e shkëmbimeve të kriptomonedhave "peer-to-peer". Për shembull, Shqipëria renditet e 96-ta në klasifikimin e futjes në përdorim në përgjithësi, por e 49-ta në volumin peer-to-peer. Bosnje-Hercegovina renditet e 115-ta në klasifikimin e futjes në përdorim në përgjithësi, por e 65-ta në volumin peer-to-peer. Kjo tregon se hetuesit e terrorizmit duhet të njihen me shkëmbimet e ndryshme "peer-to-peer" dhe me mënyrën se si funksionojnë ato.

Bullgaria dhe Serbia janë dy nga vendet e renditura më lart në rajon sa i përket futjes në përdorim në përgjithësi të kriptove, duke u renditur në vendin e 48-të dhe të 59-të nga 146 vende.

Në Indeks Global të Përdorimit të Kriptove dominojnë tregjet në zhvillim. Ndër 20 vendet e renditura më lart, 10 prej tyre janë vende që me ndeks të Bankës Botërore kategorizohen si vende

me "të ardhura të mesme deri të ulëta". Ato janë: Vietnam, Filipinet, Ukraina, India, Pakistani, Nigeria, Maroku, Nepali, Kenia dhe Indonezia.

Në këtë raport vihet në dukje se konsumatorët e kriptove në vendet me të ardhura të ulëta deri të mesme dhe të mesme deri të larta shpesh mbështeten te kriptovalutat sa i përket "dërgimit të remitancave, ruajtjes së kursimeve në kohë paqëndrueshmërisht të monedhës fiat dhe përbashkjes së nevojave të tjera financiare unike për ekonominë e tyre".

Programi OPDAT ka bashkëpunuar me Chainalysis në të kaluarën për të ofruar analiza specifike sipas vendeve sa i përket përdorimit të kriptomonedhave. Prokurorët dhe hetuesit e interesuar për të mësuar më shumë nga Chainalysis mund të kontaktojnë Këshilltarin e tyre Ligjor Rezident të OPDAT për të diskutuar në kuadrin e programeve të ardhshme.

**Burimi:** [Chainalysis The 2022 Geography of Cryptocurrency Report](#)

## Raporti GWU: Mbështetësit e Shtetit Islamik ruajnë Kalifatin Virtual përmes Përdorimit të Kriptove dhe Novacionit

Në muajin shtator, Programi mbi Ekstremizmin në Universitetin George Washington publikoi një raport, ku analizoheshin përpjekjet e mbështetësve të Shtetit Islamik (IS) për të ruajtur praninë online nëpër platforma të ndryshme dhe për të siguruar mbijetesën e të ashtuquajturit "Kalifat virtual" pas rënies së Shtetit Islamik në 2019-ën.

Sipas këtij raporti, historia e "Kalifatit virtual" filloi në Twitter në 2013-ën dhe 2014-ën, kur mbështetësit e Shtetit Islamik krijuan një numër të madh llogarish që u përdorën për përhapjen e propagandës, rekrutimin e anëtarëve të rinj, për komunikimet e brendshme dhe për nxitjen e sulmeve jashtë territorit të mbajtur nga Shteti Islamik. Pasi Twitter kreu fshirjen masive të llogarive pro-Shtetit Islamik në 2015-ën, mbështetësit e tij kaluan në platformën Telegram. Ata vazhduan të funksionojnë pa ndërprerje në Telegram deri në 2018 dhe 2019 kur Europol dhe Telegram kryen dy operacione që rezultuan në ndërprerje të konsiderueshme të aktivitetit të Shtetit Islamik në këtë platformë dhe çuan në "decentralizim të mëtejshëm të rrjeteve pro-IS pasi mbështetësit eksploruan aplikacione alternative gjithnjë e më të errëta." Pavarësisht rënies së konsiderueshme të hapësirave pro-IS në Telegram dhe përpjekjeve të mbështetësve të tij për të eksploruar platforma të tjera, raporti vë në dukje se Telegram mbetet një bazë e rëndësishme operimi për rrjetet online pro-IS, kryesisht për shkak të veçorive të privatësisë së grupeve private të Telegramit, të cilat nuk lejojnë që moderatorët e përbajtjes të shohin përbajtjen që ndajnë anëtarët e grupit me njëri-tjetrin.

Në raport theksohet se, pavarësisht nga platforma që përdorin, mbështetësit e Shtetit Islamik përdorin komunikimet online për tre qëllime: për të krijuar, për t'u lidhur dhe për të mashtruar.

### Krijimi

Sigurimi i një prodhimi të vazhdueshëm përbajtjeje pro-Shtetit Islamik ka qenë thelbësor për mirëmbajtjen e ekosistemeve virtuale pro-IS. Materialet pro-Shtetit Islamik, si lajmet zyrtare, revistat dhe videot e IS, gjenerohen nga "krijuesit e përbajtjes" të pavarur dhe përkthehen në disa gjuhë nga grupe jozyrtare përkthimi: "Bashkëpunimet brendapërbrenda projektesh të tilla në bazë mund të bëhen në nivel individual, si dhe në biseda private më të vogla në Telegram, ku një pjesë e vogël llogarish të tipit 'leadership' orientojnë grupin përmes përcaktimit të detyrave

specifike." Mbështetësit e Shtetit Islamik krijojnë edhe skedarë masivë për arkivimin e përbajtjes pro-IS për ta pasur ë të lehtë shpërndarjen e propagandës dhe burimeve të tjera (si udhëzimet për përmirësimin e sigurisë në internet, për prodhimin e eksplozivëve, etj.) tek një audiencë më e gjerë. Sipas këtij raporti, krijimi i materialeve pro-IS shkon përtej mjediseve virtuale dhe përfshin prodhimin e artikujve fizikë si veshje, veshje me temë të IS dhe vizatime artistike të punuara nga fansa të Shtetit Islamik.

### Lidhjet

Një objektivi tjetër i rëndësishëm për mbështetësit e Shtetit Islamik është garantimi i mirëmbajtjes dhe rritjes së rrjeteve të tyre. Në raport vërehet se, në varësi të platformës, ata përdorin strategji të ndryshme për arritjen e këtij qëllimi. Për shembull, mbajtja e llogarive rezervë dhe ndarja e informacionit të llogarisë rezervë me njëri-tjetrin për profile individuale, kanale pro-IS dhe biseda në grup në rast se llogaritë kryesore ndalohen, u bë reagimi kryesor ndaj përpjekjeve për bllokimin e personave të caktuar në Telegram dhe në platforma të tjera të ngjashme. Në Facebook dhe Twitter, mbështetësit e IS përdorin funksione specifike të këtyre rrjeteve të mediave sociale, si "tagging", për të shpërndarë mesazhe dhe përbajtje dhe për t'u dhënë mundësi përdoruesve të tyre pro-IS që të lidhen me njëri-tjetrin.

### Mashtrimi

Për të shmangur moderimin e përbajtjes, mbështetësit e IS investojnë shumë përpjekje për të fshehu aktivitetin e tyre në internet dhe për të aplikuar kundërmasa. Sipas këtij raporti, taktikat që ata përdorin janë përshtatur me natyrën e platformave dhe përfshijnë fshehjen e përbajtjes pro-IS përmes mashtrimit të tekste, mashtrimit vizual dhe mashtrimit me llogaritë. Për shembull, në platformat kryesore si Facebook, Twitter dhe TikTok, mbështetësit e IS përpunon të pengojnë zbulimin nga intelijenca artificiale, duke mjegulluar ose modifikuar imazhet e përbajtjes që lidhet me IS. Po kështu, ata ndryshojnë edhe hapësirat mes fjalëve ose shkronjave në një tekst, përdorin eufemizma, fjalë të koduara, gjuhë të paqartë ose edhe emoji për t'iu referuar materialeve pro-IS në mënyrë që të shmangin algoritmet e zbulimit të inteligjencës artificiale. Kur bëhet fjalë për fshehjen e llogarive në internet ose të faqeve të internetit, disa nga taktikat e identifikuar që përdorin mbështetësit e IS përfshijnë vendosjen e profileve në "modalitetin privat" për të mos lejuar akses në to nga persona të jashtëm, të paautorizuar, duke fshehur listën e miqve në Facebook që të mos u gjurmohet i gjithë rrjeti, duke krijuar kanale të dedikuara vetëm për ndarjen

e linqeve në Telegram, duke krijuar në internetin e errët faqe pasqyruese për shpërndarjen e URL-ve të përditësuara të faqeve të internetit që mund të hiqen, etj.

Sipas këtij raporti, pavarësisht nga të gjitha pengesat, mbështetësit e IS vazhdojnë të investojnë përpjekje të mëdha për të ruajtur praninë e tyre në internet dhe për të gjetur mënyra për të zgjeruar më tej shtrirjen e tyre. Operimi brenda kornizës "krijo, lidhu dhe mashtro" ka rezultuar të jetë një çelës për mbijetesën e ekosistemit në internet të Shtetit Islamik: "Duke ndjekur këto synime, mbështetësit e IS sigurojnë vazhdimësinë e prezencës së tyre online, duke u dhënë mundësinë që t'i bëjnë ballë si humbjeve të IS në botën reale dhe fushatave të shumta kundër IS-it në internet."

**Burimi:** [Meili Criezis. Krijo, Lidh dhe Mashtro: Ruajtja e kalifatit virtual përmes përshtatjes dhe novacionit nga mbështetësit e Shtetit Islamik](#)